



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 619 Akti

Nr. 713 Vendimi
Tiranë, më 9.11.2023

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Roland Ilia	Kryesues
Suela Zhegu	Relatore
Genta Tafa (Bungo)	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Etmonda Hoxha, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier de Mongeot, në datën 9.11.2023, ora 09:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancën dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Sokol Shehu**, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër.

OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE: **Pika 5 e nenit 179/b të Kushtetutës, pika 1 e nenit Ç dhe nenet D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit Sokol Shehu, aktualisht me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur në datën 15.12.2020, në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.
2. Trupi gjykues i shortuar për të shqyrtuar çështjen përbëhet nga komisionerët Suela Zhegu, me cilësinë e relatores, Roland Ilia kryesues dhe Genta Tafa (Bungo) anëtare. Në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ nga relatorja e çështjes. Subjekti i rivlerësimit u njoh me anëtarët e trupit gjykues dhe deklaroi mospasjen e konfliktit të interesit me komisionerët. Vëzhgues ndërkombëtar për këtë subjekt rivlerësimi është caktuar z. Ferdinando Buatier de Mongeot.
3. Procesi i rivlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV “Vlerësimi i pasurisë” të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht me nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimin, deklarimin dhe kontrollin e pasurive, ligjshmërinë e burimit të krijimit të tyre dhe përmbushjen e detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.
4. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (në vijim AKSIK); Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ).
5. ILDKPKI-ja në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit ka dërguar një raport¹ të hollësishëm dhe të arsyetuar, duke konkluduar se:
 - deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
 - ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
 - nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
 - nuk ka kryer deklarim të rremë;
 - subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.
6. AKSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016,

¹ Me shkresën nr. *** prot., datë 24.10.2019.

si dhe ka dërguar një raport² të arsyetuar, duke konkluduar mbi *përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Sokol Shehu*.

7. KLGJ-ja ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, pesë dokumentet e tjera ligjore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe ka dërguar një raport³ të hollësishëm dhe të arsyetuar mbi subjektin e rivlerësimit.
8. Në vijim, nga relatorja e çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016. Procesi i rivlerësimit ka nisur me një hetim administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për këtë procedurë rivlerësimi.
9. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me raportin dhe rekomandimin e relatores së çështjes, në datën 31.10.2023 vendosi përfundimin e hetimit kryesisht bazuar në të tria kriteret e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Sokol Shehu dhe njoftimin e subjektit për t'u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni dhe rezultatet e hetimit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe duke i kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të dhënë shpjegime në përputhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin D të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
10. Për një proces të rregullt ligjor, z. Sokol Shehu i janë garantuar të drejtat: (i) për t'u njoftuar për fillimin e procedurës së rivlerësimit; (ii) për t'u njohur me përbërjen e trupit gjykues; (iii) për përfundimin kryesisht të hetimit administrativ, duke i kaluar barrën e provës dhe për të dhënë shpjegimet mbi rezultatet e hetimit. Subjektit iu dha koha e nevojshme për t'u njohur me dosjen dhe për të disponuar kopje të saj.
11. Z. Sokol Shehu, pasi u njoh me rezultatet e hetimit, ka paraqitur shpjegimet dhe provat e tij në datën 7.11.2023. Subjekti i rivlerësimit lidhur me rezultatet e hetimit kundërshtoi gjetjet e konstatuara nga hetimi i kryer nga Komisioni. Trupi gjykues, pas shqyrtimit të këtyre shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi ta ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore.

II. SEANCA DËGJIMORE

12. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancë dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht në datën 7.11.2023.
13. Seanca dëgjimore u zhvillua në datën 9.11.2023, në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në ambientet e Pallatit të Koncerteve, salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier de Mongeot.
14. Në këtë seancë, subjekti i rivlerësimit u paraqit dhe u mbrojt personalisht, si dhe shprehu opinionin e tij në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer. Në përfundim, subjekti i

² Raporti mbi kontrollin e figurës për subjektin me nr. *** prot., datë 26.10.2017, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. **, datë 27.3.2023, të KDZH-së.

³ Me shkresën nr. *** prot., datë 23.9.2022.

rivlerësimit pranoi rezultatet e hetimit të kryera nga Komisioni dhe kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

15. Subjekti i rivlerësimit Sokol Shehu ka qenë bashkëpunues gjatë procesit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ, si dhe ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni. Z. Sokol Shehu ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

16. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues që mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.
17. Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.
18. Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.
19. Ndërsa, sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, AKSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.
20. Referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016 ka rezultuar se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.
21. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetimin dhe vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:
 - a. provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*;
 - b. raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
 - c. deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* dhe deklaratat periodike/vjetore të dorëzuara ndër vite nga subjekti në ILDKPKI;
 - d. provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private;
 - e. raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar në Komision nga AKSIK-ja;
 - f. raportin për vlerësimin e aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLGJ-ja;

- g. deklarimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik;
 - h. shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit të depozituar nëpërmjet postës elektronike dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.
22. Bazuar në nenin 179/b, nenet Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në ligjin nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Sokol Shehu, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, u krye mbi bazën e tri kritereve: vlerësimi i pasurisë; kontrolli i figurës; vlerësimi i aftësive profesionale.

A. VLERËSIMI I PASURISË

23. Komisioni, bazuar në ligjin nr. 84/2016, kreu një hetim administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm, i cili konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore; (ii) burimet e krijimit të kësaj pasurie; (iii) të ardhurat; (iv) shpenzimet; (v) mundësinë për fshehje të pasurisë dhe deklarim të rremë apo konflikt interesi.

Pasuritë e deklaruara në deklaratën *Vetting*

- 24. Automjet tip “Mercedes-Benz”, me targë TR *** L, vit prodhimi 1994, blerë në shumën 200.000 lekë, në bashkëpronësi me pjesë të barabarta me bashkëshorten**

Hetimi i Komisionit

24.1 DPSHTRR-ja⁴ ka konfirmuar automjetin me targë TR *** L, në pronësi të z. Sokol Shehu. Bashkëlidhur rezulton kontrata e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 30.10.2015, me shitës A.H dhe blerës Sokol Shehu, për blerje automjeti tip “Mercedes-Benz”, vlera 200.000 lekë, prodhuar në vitin 1994. Kjo shumë është shlyer *cash* nga blerësi jashtë zyrës noteriale.

24.2 Nga verifikimi i akteve rezulton se ky automjet është blerë nga shtetasi A.H në vitin 2006, në shumën 10.900 franga zvicerane.

24.3 Komisioni ka hetuar për ndonjë konflikt të mundshëm interesi të subjektit me shitësin e automjetit A.P.H dhe nga të dhënat e ardhura Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë⁵ dhe Shkodër⁶ nuk rezultoi që subjekti të ketë gjykuar ndonjë çështje gjyqësore me palë ndërgjyqëse këtë shtetas.

Burimi i krijimit

24.4 Për automjetin në pronësi, subjekti ka deklaruar si në deklaratën sipas shtojcës 2 (deklarata *Vetting*) ashtu edhe në DPV-në e vitit 2015 si burim të ardhurat e përfituara nga shitja e automjetit tip “Volkswagen Polo”, model i vitit 2001, shitur me kontratën e datës 19.1.2015.

24.5 Nga aktet e dosjes rezulton kontrata e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.1.2015, nga ku rezulton se ky automjet ka qenë në pronësi të subjektit dhe vëllait të tij dhe se është shitur në shumën 250.000 lekë.

⁴ Me shkresën nr. *** prot., datë 3.8.2021.

⁵ Me shkresën nr. *** prot., datë 21.9.2023.

⁶ Me shkresën nr. *** prot., datë 18.9.2023.

24.6 Nga aktet e depozituara nga subjekti rezulton se automjeti tip “Volkswagen Polo”, prodhuar në vitin 2009, është blerë me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.12.2009, nga subjekti Sokol Shehu dhe vëllai i tij E.Sh në shumën 500.000 lekë dhe me shitës F.Q. M.

Analiza financiare

24.7 Nga verifikimi i dokumentacionit në dosje duket se subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme nga shitja e mjetit të mëparshëm “Volkswagen Polo” për të mundësuar blerjen e mjetit të ri.

Konstatime të Komisionit

24.8 Për automjetin në pronësi të subjektit rezultoi se:

- Subjekti ka deklaruar saktë pasurinë automjet.
- Subjekti ka disponuar burime të ligjshme për blerjen e automjetit në vitin 2015.

25. Gjendje *cash* në shumën 600.000 lekë, jashtë sistemit bankar, në bashkëpronësi me bashkëshorten, me burim kursimet nga paga e subjektit, si dhe nga paga e bashkëshortes⁷

Tabela nr. 1 – Deklarimi i gjendjeve *cash* në vite

Përshkrimi	2014	2015	2016	Vetting
Shuma kumulative	200.000	350.000	550.000	600.000
Deklarimi në DPV	200.000 lekë <i>cash</i> kursime nga paga jashtë sistemit bankar	100.000 lekë <i>cash</i> jashtë sistemit bankar nga bashkëshortja dhe 50.000 lekë <i>cash</i> nga subjekti si diferencë nga shitja e automjetit	200.000 lekë kursime nga pagat e subjektit dhe bashkëshortes, <i>cash</i> jashtë sistemit bankar	

25.1 Nga verifikimi i deklarimeve të subjektit për gjendjen *cash* në vite, e llogaritur sipas deklarimeve periodike vjetore, rezultoi se subjekti kishte deklaruar në total në deklarata shumën 750.000 lekë, ndërsa në deklaratën *Vetting* ka deklaruar si gjendje *cash* të disponueshme shumën 600.000 lekë.

25.2 Për këtë mospërputhje, pasi u pyet nga Komisioni, subjekti ka shpjeguar⁸ se: “*Nuk ka mospërputhje në gjendjen cash jashtë sistemit bankar, pasi deklaratat periodike vjetore reflektojnë gjendjen cash jashtë sistemit bankar deri në datën 31.12.2016, e cila ka qenë në shumën 750.000 lekë, ndërsa shuma 600.000 lekë, e deklaruar nga ana ime si gjendje cash jashtë sistemit bankar, reflekton gjendjen cash në momentin e plotësimit të deklaratës Vetting në datën 26.1.2017*”.

Konstatim i Komisionit

25.3 Në lidhje me kursimet *cash*, deklaruar nga subjekti:

- Nga analiza financiare e të ardhurave dhe shpenzimeve të subjektit dhe bashkëshortes së tij në vite ka rezultuar se kanë pasur mundësi të mjaftueshme financiare për krijimin e gjendjes *cash* të deklaruar në deklaratën *Vetting* në shumën 600.000 lekë.

⁷ Nga punësimi i saj si sekretare dhe koordinatore e mjekëve grekë pranë spitalit privat “H.H.T”.

⁸ Në përgjigjet e pyetësorit, ardhur me shkresën nr. *** prot., datë 31.7.2023.

26. Pasuri në përdorim – apartament në Rrugën e Kavajës, Tiranë, në pronësi të babait të subjektit A.Sh

26.1 Për apartamentin në përdorim subjekti ka shpjeguar në deklaratën *Vetting* se për shkak të marrëdhënieve të posaçme prind - fëmijë banimi në këtë banesë nuk bazohet në ndonjë akt noterial sikurse e kërkojnë nenet 143, 144, 193, shkronja “b”, nenet 195, 235, 259 dhe 260 të Kodit Civil, për më tepër që mbi këtë banesë nuk kanë asnjë të drejtë pronësie apo të drejtë reale me ndonjë akt noterial.

Hetimi i Komisionit

26.2 ASHK – Drejtoria Vendore Tirana Jug⁹ ka konfirmuar pasurinë e regjistruar në emër të shtetasit A.Sh, të blerë nga shoqëria “P.C.A” sh.p.k.

26.3 DPT – Drejtoria e Hetimit Tatimor¹⁰ ka informuar se shtetasi A.A.Sh, i datëlindjes 29.6.1950, rezulton i regjistruar tek subjekti “E” sh.p.k., me NUIS L***N, regjistruar në vitin 2011 pranë DRT-së, me status “aktiv”.

26.4 QKB-ja¹¹ ka informuar se shtetasi A.A.Sh, i datëlindjes 29.6.1950, rezulton të ketë qenë administrator në subjektin “E” sh.p.k., me NUIS L***N, me objekt “Shitblerje e artikujve të ndryshëm telekomunikimi, industrialë, etj.”, larguar si administrator në datën 16.12.2019.

26.5 ISSH-ja¹² ka konfirmuar pagat bruto dhe neto të shtetasit A.Sh për periudhën dhjetor 2012 – gusht 2015, pranë subjektit “S.I-E” dhe nga muaji qershor 2015 përfiton pension pleqërie në masën 24.111 lekë dhe pension suplementar në masën 4.353 lekë.

26.6 Për shtetasen N.Sh, ISSH-ja ka konfirmuar pagat bruto dhe neto për periudhën janar 2012 e në vazhdim pranë Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Sarandë deri në korrik 2018, kur fillon të përfitojë pension pleqërie në shumën 28.303 lekë.

26.7 Në lidhje me ndonjë konflikt të mundshëm interesi, nga hetimi i Komisionit pranë Gjykatës e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë¹³ dhe Shkodër¹⁴ nuk rezultoi ndonjë çështje gjyqësore me palë ndërgjyqëse shoqërinë “P.C.A” sh.p.k., administratoren e saj V.D, ortakët e kësaj shoqërie dhe shtetasit J dhe A.V, të shqyrtuar nga subjekti i rivlerësimit Sokol Shehu.

Analiza e fakteve

26.8 Nga aktet e dosjes rezulton se babai i subjektit, z. A.Sh, ka nënshkruar kontratën e shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.4.2014. Kjo pronë është regjistruar në emër të babait të deklaruesit pranë ZVRPP-së Tiranë me nr. pasurie ***, ndodhur në z. k. ***, fakt i provuar me “vërtetim nga dokumenti hipotekor”, lëshuar në datën 22.5.2014 nga ZVRPP-ja Tiranë.

26.9 Babai i subjektit, z. A.Sh, ka lëshuar deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.1.2017, ku deklaroi se në apartamentin në pronësi të tij sa më sipër banon djali i tij me familjen. Gjithashtu, shtetasi A.Sh ka deklaruar se kjo pasuri është krijuar me të ardhurat e tij.

⁹ Me shkresën nr. *** prot., datë 20.6.2023.

¹⁰ Me shkresën nr. *** prot., datë 29.7.2021.

¹¹ Me shkresën nr. *** prot., datë 29.7.2021.

¹² Me shkresën nr. *** prot., datë 26.7.2021.

¹³ Me shkresën nr. *** prot., datë 21.9.2023.

¹⁴ Me shkresën nr. *** prot., datë 18.9.2023.

26.10 Subjekti ka shpjeguar¹⁵ se: “Midis babait tim A.Sh dhe shoqërisë “P.C” sh.p.k. nuk është lidhur ndonjë kontratë porosie përpara kontratës së shitblerjes datë 18.4.2014. Për të njëjtin apartament banimi, në datën 20.10.2006, shtetasi J.S.V ka lidhur një kontratë sipërmarrjeje me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.10.2006, me shoqërinë “P.C A” sh.p.k., me objekt kontrate porositjen e një apartamenti të cilësuar fillimisht në kontratë si AP. *, shkalla *, me sipërfaqe 99.2 m² e ndodhur në adresën Rruga e Kavajës, i-P, kulla * (sot i quajtur kompleksi “D” pranë Rrugës së Kavajës, në shumën 49.600).

Shtetasi J.V, referuar dokumentit deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.4.2014, ka deklaruar se ka filluar banimin rreth muajit shkurt të vitit 2009 dhe se ka banuar me bashkëshorten dhe dy djemtë e tij deri në muajin prill të vitit 2014.

Në datën 18.4.2014, shtetasi J.V dhe bashkëshortja e tij znj. A.V, bashkë me përfaqësuesin ligjor të shoqërisë “P.C” sh.p.k., znj. V.D, kanë nënshkruar deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., me anën e së cilës të tre së bashku kanë deklaruar përpara noterit se: “Heqin dorë nga kontrata e sipërmarrjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.10.2006 dhe se kanë qenë dakord që kontrata përfundimtare e shitjes për këtë apartament të lidhej me z. A.A.Sh, i datëlindjes 29.6.1950 dhe shoqërisë “P.C.A” sh.p.k. Në këto kushte, pasi shtetasi J.V, me cilësinë e porositësit, ka hequr dorë nga kontrata e sipërmarrjes, po në të njëjtën datë për këtë apartament banimi mes shtetasit A.Sh dhe shoqërisë “P.C.A” sh.p.k. është lidhur kontrata e shitjes së pasurisë së paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.4.2014.

Në përmbajtje të deklaratës noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.4.2014, ndërmjet palës porositëse J.V dhe sipërmarrësit shoqërisë “P.C.A” sh.p.k., është deklaruar, ndër të tjera, se janë likuiduar totalisht nga z. A.Sh, i cili nuk ka asnjë detyrim ndaj tyre.

Gjithashtu, në deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.3.2023, shtetasi J.S.V ka deklaruar ndër të tjera se: “Pasi jemi likuiduar totalisht nga z. A.Sh në vlerën 55.320 euro, shtëpia i është vënë në dispozicion shtetasit A.Sh në gjendjen siç ajo ishte”.

Pra, rezulton se sipas kontratës së shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.4.2014, të lidhur mes babait tim, shtetasit A.Sh, dhe shitësit, shoqërisë “P.C.A” sh.p.k., në të është parashikuar në nenin 2 të saj se: “Çmimi i shitjes mes palëve është rënë dakord të jetë 55.320 euro dhe palët e kësaj kontrate janë likuiduar totalisht sipas kontratës së porosisë që kanë lidhur paraprakisht ndërmjet tyre”, shuma prej 55.320 euro i është paguar shtetasit J.V si porositësi i mëparshëm i këtij apartamenti, i cili kishte paguar më parë tërësisht vlerën e apartamentit sipërmarrësit, shoqërisë “P.C.A” sh.p.k. datën që ai e kishte marrë në dorëzim apartamentin.

Sipas shpjegimeve që më ka dhënë babai, shuma i është paguar në dorë e gjitha cash shtetasit J.V, prandaj dhe nuk është pajisur me dokument/mandat”.

Burimi i krijimit

26.11 Subjekti i rivlerësimit në deklaratën Vetting ka referuar aktet ligjore, me të cilat janë krijuar të ardhurat për blerjen e kësaj pasurie. Subjekti, në përgjigje të pyetësorit¹⁶, ndër të tjera, ka shpjeguar se babai i tij, në cilësinë e pronarit të apartamentit, nuk ka asnjë detyrim ligjor për të provuar burimin e ligjshëm të kësaj pasurie, pasi në referim të pikës 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, ai nuk përfshihet në kategorinë e personave të lidhur në cilësinë e

¹⁵ Në përgjigje të pyetësorit, ardhur me shkresën nr. *** prot., datë 23.6.2023.

¹⁶ Ardhur me shkresën nr. *** prot., datë 23.6.2023.

dhuruesit, huadhënësit apo huamarrësit, pasi subjekti është vetëm përdorues i këtij apartamenti.

26.12 Në vijim, subjekti ka shpjeguar: *“Për të qenë bashkëpunues dhe transparent në procesin e rivlerësimit saktësoj se për apartamentin e blerë nga babai në vitin 2014 nuk kam asnjë kontribut financiar personalisht. Për blerjen e tij nga babai janë përdorur:*

*a) të ardhurat e krijuara nga shitja e pasurisë apartament, i ndodhur në Sarandë, me kontratën e shitblerjes me kusht rep./kol. ***, datë 18.5.2009, në shumën 3.205.152 lekë;*

*b) të ardhurat e krijuara nga shitja e pasurisë njësi tregtare, dyqan nr. * në zonën turizëm K i Ç, Sarandë, me sip. 20 m², me kontratën e shitjes rep./kol. ***, datë 17.5.2013, në shumën 1.100.000 lekë;*

c) të ardhura nga kursimet cash që dispononin prindërit nga të ardhurat që kishin realizuar bashkërisht ndër vite e të depozituara fillimisht në depozitë bankare deri në vitin 2006 e më pas tërhequr për t’u mbajtur jashtë sistemit bankar, nga të cilat janë përdorur 3.500.000 lekë për blerjen e këtij apartamenti”.

26.13 Në mbështetje të deklarimeve të tij në lidhje me burimin e krijimit të apartamentit në përdorim të tij subjekti ka depozituar aktet provuese¹⁷, të cilat janë marrë në analizë nga Komisioni.

26.14 Nga analiza e fakteve të dala gjatë hetimit rezultoi se në kohën kur është blerë apartamenti nga prindërit e tij subjekti ishte në detyrën e gjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, emëruar në datën 23.1.2014. Subjekti ka deklaruar se kjo është pasuri e krijuar me të ardhura tërësisht të prindërve dhe ai nuk ka kontribut në krijimin e saj. Komisioni nuk evidentoi ndonjë akt ligjor të nënshkruar nga subjekti apo ndonjë pagesë të kryer prej tij që ta lidhte subjektin e rivlerësimit me këtë pasuri në mënyrë formale.

Analiza financiare

27. Komisioni ka analizuar të ardhurat e prindërve të subjektit që janë përdorur si burim për krijimin e kësaj pasurie në shumën 55.320 euro (e konvertuar në shumën 7.750.885 lekë me kursin e vitit 2014), sipas shpjegimeve të subjektit dhe deklaratës së lëshuar nga babai i tij si vijon:

- të ardhurat nga shitja e pasurisë apartament, i ndodhur në Sarandë, me kontratën e shitblerjes me kusht nr. *** rep./kol., datë 18.5.2009, në shumën 3.205.152 lekë;
- të ardhurat nga shitja e pasurisë njësi tregtare, dyqan nr. * në zonën turizëm K i Ç, Sarandë, me sip. 20 m², me kontratën e shitjes nr. *** rep., nr. ***kol., datë 17.5.2013, në shumën 1.100.000 lekë; shuma totale e përfituar nga babai i subjektit nga shitja e dy pasurive rezulton në 4.305.152 lekë; nga verifikimi i dokumentacionit, këto të ardhura duket se janë përfituar *cash* dhe jo me bankë;
- diferencën për blerjen e apartamentit në shumën rreth 3.500.000 lekë subjekti ka deklaruar se babai e ka mbuluar me kursimet që ka pasur në bankë, të cilat i ka tërhequr në vitin 2006.

27.1 Komisioni verifikoi llogaritë bankare të prindërve të subjektit nga ku u evidentua se babai ka pasur një depozitë të çelur në Tirana Bank, në muajin dhjetor 2001, në shumën 55.580 USD. Kjo shumë është depozituar *cash* në datën 24.12.2001 dhe ka qëndruar e

¹⁷ Sipas shkresës ardhur me nr. *** prot., datë 23.6.2023 dhe inventarit përkatës të dokumentacionit.

bllokuar në depozitë me interes deri në datën 26.6.2006, kur është tërhequr e gjithë shuma *cash* bashkë me interesat në total 59.797 USD, nga babai i subjektit.

27.2 Në përfundim të analizës financiare të kryer nga Komisioni ka rezultuar se prindërit e subjektit kanë pasur mundësi financiare për blerjen e apartamentit në vitin 2014.

Konstatime të Komisionit

28. Për apartamentin në përdorim:

- Subjekti ka deklaruar saktë pasurinë në përdorim, në pronësi të babait.
- Deklarimet e subjektit përputhen me aktet e administruara në dosje.
- Nga analiza financiare e Komisionit ka rezultuar se prindërit e subjektit kanë disponuar burime të ligjshme për blerjen e apartamentit.
- Nga analizimi i akteve të administruara nuk u konstatuan gjetje që të lidhin subjektin e rivlerësimit me këtë pasuri.

Konkluzion përfundimtar mbi kriterin e pasurisë

29. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti ka deklaruar saktësisht e plotësisht në deklaratën *Vetting* pasuritë e tij dhe të personave të lidhur me të. Subjekti ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë. Ai ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së tij. Nga hetimi ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit nuk është përpjekur të fshehtë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij.

29.1 Trupi gjykues, duke marrë në konsideratë të gjitha konstatimet e arsyetuara sa më sipër, çmon se referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe dispozitave të kreut IV të ligjit nr. 84/2016, krijoi bindjen se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.

B. KONTROLLI I FIGURËS

30. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikojë nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

30.1 AKSIK-ja ka dërguar raportin në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016 mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, ku ka konstatuar përshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit Sokol Shehu në detyrën e gjyqtarit.

Vlerësimi i Komisionit mbi kontrollin e figurës

30.2 Komisioni, si organ i legjitimuar nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 për të bërë rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ka hetuar në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.

30.3 Komisioni ka kërkuar përditësim të raportit të dërguar nga AKSIK-ja në vitin 2017 për të cilën është informuar mbi të dhëna shtesë për periudhën 2017 – 2022. Dosjet dhe

informacionet e referuara nga institucionet ligjzbatuese u analizuan nga Komisioni dhe, përfundimisht, u konstatua se nuk u gjendën elemente që cenonin figurën e subjektit të rivlerësimit. Pavarësisht këtij konstatimi, këto dosje janë analizuar nga Komisioni dhe u vlerësuan lidhur me kriterin e aftësive profesionale.

30.4 Në përfundim të rivlerësimit për kriterin e kontrollit të figurës, Komisionit i rezultoi se subjekti i rivlerësimit Sokol Shehu arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të nenit 59/1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, pasi nga verifikimet e kryera nuk rezultoi se ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ka dorëzuar në kohë deklaratën për figurën, si dhe e ka plotësuar saktë atë.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

31. Hetimi i Komisionit lidhur me këtë kriter është bazuar në analizimin e:

- raportit të hartuar nga KLGJ-ja për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit;
- kriterëve të vlerësimit të parashikuara në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (neni 71 e vijues i tij);
- denoncimeve të paraqitura nga publiku sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016.

31.1 KLGJ-ja ka hartuar një raport vlerësimi profesional për subjektin e rivlerësimit të hollësishëm dhe të arsyetuar, bazuar në:

- formularin e vetëdeklarimit;
- 3 dokumentet ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe në të dhënat e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit, të dhëna nga burimet arkivore;
- 5 dosjet gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor.

32. GJETJET NGA FORMULARI I VETËDEKLARIMIT DHE DOKUMENTET E PARAQITURA NGA SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT

a) Saktësia e formularit të vetëdeklarimit

Formulari paraqitet i plotësuar sipas shtojcës së ligjit. Të gjitha rubrikat janë plotësuar me saktësi, me shkrim të qartë e të lexueshëm. Formulari është nënshkruar rregullisht në çdo faqe.

b) Përvoja profesionale në 10 vitet e fundit

Sipas formularit të vetëdeklarimit, subjekti i rivlerësimit Sokol Shehu në periudhën nëntor 2007 – tetor 2009 ka punuar si asistent avokat pranë studios së avokatisë “K”. Në periudhën nëntor 2011 – janar 2014 ka kryer stazhin profesional si kandidat për magjistrat në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe në periudhën janar 2014 e në vijim ka ushtruar detyrën e gjyqtarit pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër.

c) Detyrat e kryera 3 vitet e fundit

Subjekti i rivlerësimit Sokol Shehu ka deklaruar se në tri vitet e fundit ka punuar si gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër në fushën e së drejtës civile-tregtare dhe penale, duke gjykuar edhe çështje penale në seksionin për të miturit.

ç) Trajnimet në 3 vitet e fundit

Sipas të dhënave të pasqyruara në formularin e vetëdeklarimit, gjyqtari Sokol Shehu ka qenë pjesëmarrës në 17 aktivitete trajnuese.

d) Tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit

Subjekti i rivlerësimit Sokol Shehu ka depozituar 3 dokumente ligjore të llojit vendim gjyqësor. Me analizimin e akteve, në njërin nga këto akte, përkatësisht në dokumentin që i përket vendimit gjyqësor civil të datës 3.5.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, Komisioni ka konstatuar se gjykimi i kësaj çështjeje nga gjyqtari Sokol Shehu ka zgjatur 1 vit, 2 muaj e 10 ditë, në shkelje të afatit standard 6-mujor, të përcaktuar nga pika 5, shkronja “e” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit. Në lidhje me këtë konstatim të Komisionit subjektit iu kërkuan shpjegime.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në prapësime

32.1 Subjekti në prapësimet e rezultateve të hetimit të depozituar prej tij në datën 7.11.2023 ka argumentuar se kohëzgjatja e gjykimit të çështjes së konstatuar nga Komisioni ka ardhur për shkaqe objektive dhe të arsyeshme, si dhe për një hetim të gjithanshëm të çështjes, duke shpjeguar hapat proceduralë të ndjekur prej tij, si vijon:

- a. Si fillim, me të marrë dijeni pala e paditur për procesin gjyqësor të ngritur kundër saj, përfaqësuesi ligjor i tyre ka kërkuar kohë të njihet me padinë dhe aktet bashkëlidhur dhe, gjykata, për t'i dhënë kohë palës së paditur për të përgatitur mbrojtjen në kuadër të së drejtës për një proces të rregullt gjyqësor, ka vendosur shtyrjen e seancës përgatitore për një datë tjetër.
- b. Me kalimin e çështjes në seancë gjyqësore gjatë debatit mbi provat ka lindur nevoja që dokumentacioni i pronës së paditësit të merrej i rifreskuar pranë ish-ZVRPP-së Shkodër.
- c. Janë shtyrë 5 seanca gjyqësore, pasi ZVRPP-ja Shkodër nuk depozitonte aktin e rifreskuar të pronësisë mbi pronën, ndonëse një gjë e tillë ishte urdhëruar nga gjykata.
- ç. Gjykata me kërkesë të palëve vendosi kryerjen e një akti ekspertimi teknik-topografik nga një ekspert ing. gjeodet, i cili kërkoi minimumi 20 ditë kohë për të përfunduar aktin e ekspertimit; për këtë arsye, gjykata ka shtyrë seancën pas 20 ditësh, për t'i lënë kohën e nevojshme ekspertit.
- d. Seanca e radhës u shty përsëri me kërkesë të ekspertit, pasi ai kishte shpjeguar se i duhet më shumë kohë për të përfunduar aktin e ekspertimit, pasi kishte hasur probleme gjatë këqyrjes në vend të pronës, pasi aty kishin pretendime edhe disa banorë të tjerë, posedues të kësaj prone, që nuk ishin palë në këtë gjykim.
- e. Kur u paraqit akti i ekspertimit, palët kërkuan kohë të njihen me aktin e ekspertimit dhe gjykata shtyu sërish seancën për një datë tjetër.
- ë. Pasi palët u njohën me aktin dhe filloi debati mbi përmbajtjen e tij, prej tyre u konstatua se akti i ekspertimit nuk i kishte dhënë zgjidhje të gjitha detyrave të ngarkuara nga Gjykata dhe lindi nevoja për kryerjen e një akti ekspertimi shtesë prej ekspertit, i cili u bë shkak sërish për shtyrjen e seancës brenda një afati të përshtatshëm të kërkuar nga eksperti për aktin shtesë të ekspertimit.

- f. Me paraqitjen e aktit shtesë palët kërkuan kohë të njiheshin dhe të përgatisnin pyetjet mbi ekspertin dhe kundërshtimet e tyre mbi aktin.
- g. Pas përfundimit të debatit mbi provat, Gjykata ka mbyllur shqyrtimin gjyqësor dhe ka shtyrë seancën, për t'u lënë kohë palëve të përgatisin bisedimet përfundimtare brenda afatit ligjor.
- gj. Periudha e shqyrtimit gjyqësor të kësaj çështjeje 23.2.2015 – 3.5.2016 ka përfshirë muajin gusht (kur gjykata mbyllet), si dhe festat e fundvitit.

Vlerësimi i Komisionit

32.2 Komisioni vlerëson se çështja e trajtuar nga subjekti ka rezultuar komplekse. Gjykata, në zbatim të nenit 14 të Kodit të Procedurës Civile, ka detyrimin të zhvillojë një proces të rregullt ligjor nëpërmjet garantimit të zhvillimit të një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm, në përputhje me ligjin. Në zbatim të kësaj dispozite, gjatë hetimit gjyqësor, sikurse ka shpjeguar dhe subjekti, ka qenë i nevojshëm realizimi i një akti ekspertimi, si dhe kryerja e një akti shtesë ekspertimi, i cili ka krijuar shtyrje të seancave dhe zgjatje të afatit.

32.3 Gjykata, në zbatim të nenit 20 të Kodit të Procedurës Civile, duhet të ndjekë dhe të kërkojë të zbatohet parimi i kontradiktoritetit, duke u dhënë mundësi palëve të njihen me çdo provë në mënyrë efektive, si dhe të paraqesin pyetje dhe pretendime shtesë në lidhje me aktin e ekspertimit të ekspertëve, hapa këta të cilët kanë krijuar shtyrje të afatit.

32.4 Në lidhje me këtë çështje, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut¹⁸ ka mbajtur qëndrimin se kriteret që përcaktojnë afatin e arsyeshëm për gjykimin e një çështjeje konkrete janë:

- shkalla e kompleksitetit të çështjes;
- sjellja e palëve në proces;
- sjellja e organeve kompetente për shqyrtimin e çështjes.

32.5 Në rastin konkret konstatohet se çështja ka qenë komplekse, ka pasur vonesa për shkak të mosbashkëpunimit nga ana e ZVRPP-së Shkodër për të vënë në dispozicion dokumente të rifreskuara të pronës që po i nënshtrohej shqyrtimit gjyqësor dhe se procesi nuk është shtyrë për shkaqe të pajustificuara nga ana e subjektit të rivlerësimit.

32.6 Rrethanat e mësipërme janë shkaqe të cilat kanë bërë që kjo çështje të mos përfundonte brenda afatit 6-mujor, parashikuar nga Aneksi 1 i sistemit të vlerësimit.

5 DOSJET GJYQËSORE TË PËRZGJEDHURA ME SHORT

- 33. Nga analizimi i 5 dosjeve nga Komisioni, në dosjet 1, 2 dhe 5 nuk janë evidentuar problematika.
- 34. **Në dosjen nr. 3**, që i përket çështjes civile të regjistruar në vitin 2015, me palë paditëse shtetasen S. L. kundër të paditurit OSHEE sh.a. Shkodër, me objekt “Anulim gjobe”. Kjo çështje është përfunduar nga subjekti i rivlerësimit në datën 29.10.2015. Referuar akteve, ka rezultuar se gjykimi i çështjes ka zgjatur 6 muaj e 27 ditë, në tejkalim të afatit standard 6-mujor, të përcaktuar nga pika 5, shkronja “e” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit. Nga

¹⁸ Shihni vendimin e GJEDNJ-së K.K de la Grange kundër Italisë, nr. kërkesë ***, datë 27.10.1994.

dokumentacioni në dosjen e vëzhguar nuk konstatohen të meta. Në lidhje me këtë konstatim të Komisionit, subjektit iu kërkuan shpjegime.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në prapësime

34.1 Subjekti në prapësime ka shpjeguar se gjykimi i çështjes ka zgjatur 6 muaj e 27 ditë, në intervalin kohor 2.4.2015 – 29.10.2015. Lidhur me tejkalinimin e afatit me 27 ditë nga ai standard 6-mujor, subjekti ka shpjeguar se në këtë llogaritje nuk është marrë në konsideratë periudha e muajit gusht 2015, për shkak të lejes vjetore, e cila sipas ligjit merret vetëm në muajin gusht të çdo viti kalendarik, ku, edhe gjykatat në të gjithë vendin janë të mbyllura.

Vlerësimi i Komisionit

34.2 Komisioni vlerëson se shpjegimet e subjektit duken bindëse në lidhje me shkaqet që e kanë çuar në shkelje të afateve të shqyrtimit të çështjes, duke vlerësuar këtu që shkelja e afatit është vetëm me 27 ditë.

35. **Në dosjen nr. 4**, që i përket çështjes civile të regjistruar në datën 9.11.2015, me palë: paditës shtetasin B. Ç. etj; të paditur Drejtorinë Rajonale të Entit Kombëtar të Banesave Dega Shkodër; persona të tretë Drejtorinë e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike pranë Ministrisë së Financave Tiranë, me objekt “Detyrimi për njohjen pronar mbi pasurinë e ndodhur në qytetin Shkodër...”.

35.1 Gjykimi i kësaj çështjeje ka përfunduar në datën 21.7.2016, pra ka zgjatur 7 muaj e 12 ditë, në shkelje të afatit standard 6-mujor të përcaktuar nga pika 5, shkronja “e” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit. Subjektit iu kërkuan shpjegime për gjykimin e çështjes tej afatit 6-mujor.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në prapësime

35.2 Subjekti ka shpjeguar se shkelja e afatit të shqyrtimit të çështjes ka ardhur për shkaqe të arsyeshme, ku ndër të tjera argumenton se:

“a. Seancat gjyqësore janë shtyrë disa herë për mosmarrje dijëni të palëve në proces.

*b. Gjykata e Apelit Shkodër¹⁹ në lidhje me këtë çështje kishte vendosur prishjen e vendimit nr. ***, datë 14.11.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe dërgimin e çështjes për rigjykim me tjetër trup gjykues, duke arsyetuar se: “Vendimi nr. ***, datë 14.11.2013, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, duhet të priset dhe çështja të dërgohet për rigjykim me tjetër trup gjykues, pasi nuk është formuar drejt ndërgjyqësia”. Për këto arsye, gjatë rigjyimit të çështjes, në cilësinë e gjyqtarit kisha detyrimin të merrja të gjitha masat për orientimin e palëve që të rregullonin ndërgjyqësinë në këtë proces. Në këto kushte, gjatë rigjyimit të çështjes palës paditëse iu bashkuan si paditës edhe shtetasit N. B. dhe S. B., ndërsa trashëgimtarja ligjore tjetër e të ndjerit R. C., shtetasja I. C., bazuar në nenin 189 të Kodit të Procedurës Civile ndërhyri si ndërhyrëse kryesore kundër të paditurit nga padia Entit Kombëtar të Banesave Drejtoria Rajonale Shkodër, duke u përmbushur në këtë mënyrë detyrat e lëna nga Gjykata e Apelit Shkodër lidhur me rregullimin e ndërgjyqësisë me vendimin nr. ***, datë 15.4.2015. Të gjitha këto veprime procedurale kërkuan kohën e tyre dhe u bënë shkak për shtyrjen e seancave gjyqësore disa herë, pasi ato duhet t’u njoftoheshin detyrimisht edhe palëve në mungesë,*

¹⁹ Me vendimin nr. ***, datë 15.4.2015.

konkretisht Zyrës së Avokaturës së Shtetit Shkodër (në mungesë), si dhe personit të tretë në padi dhe ndërhyrjen kryesore Drejtoria e Administrimit të Shitjes së Pronave Publike Tiranë pranë Ministrisë së Financave Tiranë (në mungesë).

- c. Në vijim, gjykata caktoi një ekspert ing. topograf dhe një ekspert vlerësues pasurish të paluajtshme, të cilët kërkuan kohë të mjaftueshme mbi 20 ditë për të përfunduar aktin e ekspertimit; për këtë arsye, gjykata ka shtyrë seancën për t'u lënë gjithë kohën e nevojshme ekspertëve.*
- ç. Pasi ekspertët morën kohën e nevojshme, ata paraqitën aktin e ekspertimit në seancën e radhës dhe palët kërkuan kohë të njihen me aktin e ekspertimit, gjykata shtyu sërish seancën për një datë tjetër.*
- d. Pasi palët u njohën me aktin dhe filloi debati mbi përmbajtjen e tij, nga palët u konstatua se akti i ekspertimit nuk u kishte dhënë zgjidhje të gjitha detyrave të ngarkuara nga gjykata dhe lindi nevoja për kryerjen e një akti ekspertimi shtesë prej ekspertëve, i cili u bë shkak sërish për shtyrjen e seancës brenda një afati të përshtatshëm.*
- dh. Pastaj, sërish palët me paraqitjen e aktit shtesë kërkuan kohë të njiheshin dhe të përgatisnin pyetjet mbi ekspertin dhe kundërshtimet e tyre mbi aktin.*
- e. Prej datës 25.12.2015 – 13.1.2016 gjykata nuk ka zhvilluar seanca gjyqësore për shkak të festave të fundvitit dhe procesit të mbaritjes së dosjeve nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër.*
- ë. Në vijim, në nenin 399/2, pika 3 e Kodit të Procedurës Penale, parashikohet se: “Në kohëzgjatjen e gjykimit ose të procedimit nuk llogaritet koha kur çështja është pezulluar për shkaqe ligjore, kur është shtyrë për shkak të kërkesave të palës kërkuese sipas këtij kreu ose kur shfaqen rrethana të pamundësisë objektive për procedim.”*
- f. Së fundi, vlen të theksohet se për shkak të ngarkesës shumë të madhe të gjyqtarit për periudhën që i përket dhe gjykimit të kësaj çështjeje, ka qenë e pamundur shtyrja e seancave në data shumë të afërta nga njëra-tjetra”.*

Vlerësimi i Komisionit

35.3 Trupi gjykues çmon se subjekti ka argumentuar dhe arsyetuar shkaqet, të cilat kanë çuar në zgjatje të afateve të gjykimit të çështjes. Komisioni vlerëson se çështja e trajtuar nga subjekti ka rezultuar se ka qenë komplekse dhe me shumë palë ndërgjyqëse, duke mbajtur këtu në vëmendje detyrat e lëna nga Gjykata e Apelit Shkodër, e cila e kishte kthyer çështjen për rigjykim. Gjykata, në zbatim të nenit 14 të Kodit të Procedurës Civile, ka detyrimin që të zhvillojë një proces të rregullt ligjor nëpërmjet garantimit të zhvillimit të një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm, në përputhje me ligjin. Në zbatim të kësaj dispozite, gjatë hetimit gjyqësor, sikurse ka shpjeguar edhe subjekti, ka qenë i nevojshëm realizimi i një akti ekspertimi, si dhe kryerja e një akti shtesë ekspertimi, i cili ka krijuar shtyrje të seancave dhe zgjatje të afatit.

35.4 Gjykata, në zbatim të nenit 20 të Kodit të Procedurës Civile, duhet të ndjekë dhe të kërkojë të zbatohet parimi i kontradiktoritetit, duke u dhënë mundësi palëve të njihen me çdo provë në mënyrë efektive, si dhe të paraqesin pyetje dhe pretendime shtesë në lidhje me aktin e ekspertimit të ekspertëve, ku edhe këta hapa proceduralë kanë krijuar shtyrje të afatit.

35.5 Nga vlerësimi tërësor i tyre nuk u evidentuan rrethana që përbëjnë shkelje procedurale të tilla, që mund të çojnë në konkluzione negative lidhur me kriterin e rivlerësimit të aftësive profesionale.

TË DHËNA NGA BURIME ARKIVORE TË KLGJ-së

36. Sipas të dhënave nga burimet arkivore, gjatë periudhës së rivlerësimit për gjyqtarin Sokol Shehu janë paraqitur 4 ankesa në Inspektoratin e ish-KLD-së. Sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore, për gjyqtarin Sokol Shehu përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk rezultoi që ndaj tij të ketë ardhur ndonjë kërkesë për procedim disiplinor apo të jetë dhënë ndonjë masë disiplinore nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë.
37. ILD-ja²⁰ ka depozituar ankesat e paraqitura pranë këtij institucioni dhe nga verifikimi ka rezultuar se:

37.1 Në vitin 2015, shtetasja Xh.S. ka depozituar pranë ish-KLD-së një ankesë për shkelje procedurale nga ana e subjektit të rivlerësimit. Ankuesja rezultoi të ketë qenë palë në një proces gjyqësor civil të zhvilluar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me objekt “Kundërshtim të veprimeve përmbartimore, sigurim padie me pezullim të ekzekutimit të titullit ekzekutiv të vendimit gjyqësor nr. ***, datë 28.7.2010”. Ankuesja ka pretenduar se nga ana e subjektit të rivlerësimit është shqyrtuar kërkesa për sigurimin e padisë dhe gjyqtari ka vendosur në seancë (duke e shpallur në mënyrë verbale) pranimin e kërkesës për sigurimin e padisë. Ankuesja ka pretenduar gjithashtu se gjyqtari nuk e ka zbardhur vendimin e ndërmjetëm dhe në seancën vijuese ankuesja ka mësuar se gjyqtari e ka rrëzuar kërkesën për sigurimin e padisë. Pra, sipas ankueses, gjyqtari është shprehur dy herë në mënyra të ndryshme mbi kërkesën e saj për sigurimin e padisë. Ish-KLD-ja ka vendosur arkivimin, pasi në kohën e analizimit të ankesës çështja ishte ende në shqyrtim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër.

37.2 Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit në lidhje me vendimmarrjen e tij për kërkesën e sigurimit të padisë.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

37.3 Subjekti i rivlerësimit në prapësimet e depozituar prej tij ka shpjeguar se:

“a. Në lidhje me kërkesën për sigurimin e padisë, Gjykata brenda detyrimit ligjor prej 5 (pesë) ditësh, që parashikonte nenet 202 dhe 609 të Kodit të Procedurës Civile nga dita që i vinte dosja fizikisht gjyqtarit, zhvilloi seancën përgatitore, ku mori në shqyrtim fillimisht kërkesën e parë për sigurimin e padisë të vënë në objektin e kërkesëpadisë dhe, pasi dëgjoi dhe shqyrtoi provat dhe me vendimin e ndërmjetëm të datës 26.3.2015 ka vendosur rrëzimin e kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të titullit ekzekutiv.

b. Vendimi i ndërmjetëm, për të cilin ligji parashikonte edhe ankim të veçantë, është arsyetuar nga unë, gjyqtari Sokol Shehu, brenda 5 ditëve dhe i është dhënë sekretares gjyqësore për ta zbritur në kryesekretari... Por, nga ana e sekretares gjyqësore kur ishte zbritur vendimi i ndërmjetëm prej saj, nga pakujdesia nuk ishin bërë shënimet në regjistrin përkatës të dorëzimit të vendimeve të arsyetuara dhe, për pasojë, vetëm pasi pala ishte ankuar edhe unë gjyqtari jam vënë në dijeni se vendimi i ndërmjetëm i arsyetuar prej meje brenda afatit 5-ditor, figuronte i padorëzuar në kryesekretari.

²⁰ Me shkresën nr. *** prot., datë 25.9.2023.

- c. *Theksoj gjithashtu se gjatë gjithë karrierës sime si gjyqtar nuk më ka ndodhur asnjëherë që të vonoj arsyetimin dhe të dorëzoh me vonesë vendimet, për të cilat ligji parashikon ankim të veçantë e sidomos kur bëhet fjalë për palë ndërgjyqëse e konflikte gjyqësore problematike, ndaj edhe parregullsia e mësipërme theksoj se ka ardhur vetëm si pakujdesi e sekretares gjyqësore në uljen e vendimit në kryesekretari dhe mosbërjen e shënimeve përkatëse dhe jo për fajin e subjektit të rivlerësimit, gjyqtarit Sokol Shehu”.*

Vlerësimi i Komisionit

37.4 Komisioni ka evidentuar nga dosja gjyqësore e depozituar prej subjektit se në procesverbalin e seancës përgatitore të datës 26.3.2015 subjekti ka marrë në shqyrtim kërkesën paraprake të palës paditëse “Sigurimin e padisë për pezullimin e veprimeve përmbartimore” brenda afatit ligjor të parashikuar. Pas shqyrtimit të kësaj kërkesë, subjekti në të njëjtën seancë gjyqësore e ka rrëzuar. Më tej, gjykata ka vijuar seancën e veprimeve përgatitore lidhur me kërkimin tjetër të objektit të padisë “Kundërshtimi i veprimeve përmbartimore...”.

37.5 Nga aktet e depozituara nga subjekti rezulton në dosje edhe vendimi i arsyetuar (vendimi për masën e sigurisë) i së njëjtës datë, por nga dosja nuk evidentohet se kur është arsyetuar vendimi i ndërmjetëm për rrëzimin e masës së sigurisë dhe se kur i është dhënë sekretares gjyqësore për ta depozituar në kryesekretari, sikurse shpjegon subjekti.

37.6 Për sa më sipër, pretendimi i subjektit që vendimi i ndërmjetëm është arsyetuar dhe zbritur në kryesekretari brenda afatit ligjor, është në nivel deklarativ dhe mbeti i paprovuar e i padokumentuar prej subjektit.

38. Ankesë nr. ***, datë 18.9.2015, e depozituar në ish-KLD nga shtetasi E. Sh., me pretendimin për zvarritje të gjykimit nga gjyqtari Sokol Shehu, në çështjen civile me objekt “Lirim e dorëzim sendi”.

38.1 Nga verifikimi i akteve që lidhen me kërkesëpadinë e paditësit Gj.Sh., babai i ankuesit, kundër 30 të paditurve, me objekt “Lirim e dorëzim sendi”, rezultoi se fashikulli civil ishte regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër në datën 16.1.2014 dhe në shortin e zhvilluar në datën 10.3.2014 çështja i ka rënë për gjykim gjyqtarit Sokol Shehu.

38.2 Nga aktet e fashikullit gjyqësor rezulton se janë zhvilluar gjithsej 6 seanca përgatitore dhe 21 seanca gjyqësore.

38.3 Lidhur me pretendimet e ankuesit për zvarritje të gjykimit të çështjes, referuar pikës 5, shkronja “e” e vendimit nr. ***, datë 14.4.2010, të KLD-së “Mbi kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore”, afati i gjykimit të mosmarrëveshjeve civile të karakterit të përgjithshëm nga gjykata e shkallës së parë është parashikuar të jetë jo më tej se 6 muaj.

38.4 Në këto rrethana, pretendimi i ankuesit për zvarritje në gjykim në këtë çështje qëndron, pasi periudha nga data 10.3.2014 e deri në seancën e datës 3.12.2015, afro 1 vit e 9 muaj, është jashtë afatit 6-mujor të përcaktuar për këto lloj gjykimesh. Në lidhje me këtë konstatim të Komisionit për zvarritje të gjykimit subjektit iu kërkuan shpjegime.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në prapësime

38.5 Subjekti në prapësimet e rezultateve të hetimit shpjegoi se zgjatja në kohë e procesit gjyqësor nuk ka ardhur për faj të gjykatës, por për shkak të kompleksitetit të çështjes, veprimeve të vetë palëve ndërgjyqëse, paditësit dhe të paditurve.

38.6 Ky tejkalim afati ka ardhur nga fakti se procesi ka qenë tepër kompleks, me shumë palë ndërgjyqëse, 29 të paditur, të cilët janë shtuar e pakësuar disa herë gjatë gjykimit nga vetë pala paditëse. Po kështu, janë realizuar gjatë gjykimit dy akte ekspertimi dhe është paraqitur e shqyrtuar një kërkesë për përjashtimin e gjyqtarit Sokol Shehu nga gjykimi dhe kërkesa të tjera, të parashtruara nga palët gjatë gjykimit.

Vlerësimi i Komisionit

38.7 Komisioni vlerëson se shkaqet e shtyrjes së seancave gjyqësore kanë qenë ligjore dhe kanë ardhur për shkaqe objektive, si ngarkesa e lartë në punë, kompleksiteti i çështjes, sjellja e palëve në proces etj. Komisioni nuk konstatoi zvarritje të pajustificuara të procesit, që të mund të konsiderohen shkelje në referim të detyrave të subjektit të rivlerësimit.

38.8 Përfundimisht, u konkludua se gjykimi tej afateve të përcaktuara sipas rregullores ka qenë i arsyeshëm dhe jo për faj të keqmenaxhimit të çështjes nga ana e gjyqtarit.

39. Ankesë e depozituar pranë ish-KLD-së me nr. *** prot., datë 1.7.2016; nga informacioni periodik i dërguar nga kryetari i Gjykatës së Rrethit Shkodër referohet fakti i dorëzimit me vonesë nga gjyqtari Sokol Shehu i një vendimi të ndërmjetëm të dhënë nga ai në datën 21.4.2016, lidhur me një kërkesë për sigurim padie.

39.1 Nga verifikimi i informacionit të dërguar nga kryetari i Gjykatës së Rrethit Shkodër me të dhënat e pasqyruara në librin e dorëzimit të vendimeve nga gjyqtarët e asaj gjykate rezultoi që vendimi i ndërmjetëm i gjyqtarit Sokol Shehu është dorëzuar pas 48 ditësh nga shpallja e tij, ndërkohë që duhet të ishte dorëzuar brenda një afati 5-ditor. Në lidhje me këtë konstatim të Komisionit subjektit iu kërkua të jepte shpjegime.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në prapësime

39.2 Subjekti ka shpjeguar: *“Paditësja P. M. më 13.4.2016 i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër me kërkesëpadinë me objekt “Sigurimi i padisë dhe pezullimi i ekzekutimit të titullit ekzekutiv dhe urdhrin të ekzekutimit të lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër me vendimin nr. *, datë 11.1.2016”.*

Gjykata, nisur nga fakti që një nga kërkimet e padisë kishte karakter të ngutshëm që lidhet me sigurimin e padisë, brenda detyrimit ligjor prej 5 (pesë) ditëve, që parashikonin nenet 202 dhe 609 të Kodit të Procedurës Civile nga dita që i vinte dosja fizikisht gjyqtarit, zhvilloi seancën përgatitore, ku mori në shqyrtim fillimisht kërkesën e parë për sigurimin e padisë të vënë në objektin e kërkesëpadisë dhe, pasi dëgjoi dhe shqyrtoi provat me vendimin e ndërmjetëm të datës 21.4.2016, ka vendosur rrëzimin e kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të titullit ekzekutiv.

Ky vendim i ndërmjetëm, për të cilin ligji parashikonte dhe ankim të veçantë, është arsyetuar nga unë gjyqtari Sokol Shehu brenda 5 ditëve dhe i është dhënë sekretares gjyqësore për ta zbritur në kryesekretari dhe, në momentin që njëra prej palëve do të paraqiste ankim, ky vendim, së bashku me një pjesë të dosjes gjyqësore deri në atë fazë që ndodhej gjykimi, do të fotokopjohej, në mënyrë që të shkonte si dosje më vetë në Gjykatën e Apelit Shkodër dhe të mos pengonte shqyrtimin e themelit të padisë.

Por nga ana e sekretares gjyqësore, kur ishte zbritur vendimi i ndërmjetëm prej saj, nga pakujdesia nuk ishin bërë shënimet në regjistrin përkatës të dorëzimit të vendimeve të arsyetuara dhe, për pasojë, vetëm pasi pala ishte ankuar, jam vënë në dijeni se vendimi i ndërmjetëm i arsyetuar prej meje brenda afatit 5-ditor figuronte i padorëzuar në kryesekretari.

Theksoj gjithashtu se gjatë gjithë karrierës sime si gjyqtar nuk më ka ndodhur asnjëherë që të vonoj arsyetimin dhe të dorëztoj me vonesë vendimet, për të cilat ligji parashikon ankim të veçantë e sidomos kur bëhet fjalë për palë ndërgjyqëse e konflikte gjyqësore problematike, ndaj edhe parregullsia e mësipërme theksoj se ka ardhur vetëm si pakujdesi e sekretares gjyqësore në uljen e vendimit në kryesekretari dhe mosbërjen e shënimeve përkatëse dhe jo për fajin e subjektit të rivlerësimit, gjyqtarit Sokol Shehu”.

Vlerësimi i Komisionit

39.3 Komisioni arsyeton se shpjegimet e subjektit janë në nivel deklarativ dhe të pambështetura në dokumentacion provues. Subjekti nuk arriti të provojë se ka arsyetuar dhe i ka dorëzuar sekretares vendimin e ndërmjetëm brenda afateve ligjore të parashikuara në ligj.

ANALIZA E GJETJEVE

40. Nga analizimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short ka rezultuar se:

40.1 Në lidhje me aftësitë profesionale, subjekti i rivlerësimit, gjyqtari Sokol Shehu, ka shfaqur aftësi të mira në arsyetimin ligjor të vendimeve. Vendimet e arsyetuara prej tij janë të qarta, të kuptueshme dhe bëhet interpretim i provave dhe çfarë u provua me përmbajtjen e tyre. Vendimet e ndërmjetme shoqërohen me referencë ligjore.

40.2 Aftësitë organizative

Sipas të dhënave statistikore, konstatohet se për periudhën e rivlerësimit 8.10.2013 – 8.10.2016 gjyqtari Sokol Shehu ka përfunduar së gjykuari 1323 çështje, nga këto 660 çështje janë mosmarrëveshje civile me palë kundërshtarë, duke tejkuluar me gati dyfishin standardin sasior, si dhe 452 çështje penale të gjykuara.

Në analizë të të dhënave të mësipërme Komisioni vlerëson se gjyqtari Sokol Shehu është eficient dhe efektiv.

40.3 Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave dhe i procedimeve disiplinore nuk konstatohen të dhëna negative për etikën në punë të gjyqtarit Sokol Shehu. Nga aktet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit. Nuk janë konstatuar raste që gjyqtari Sokol Shehu të mos ketë respektuar rregullat procedurale, që lidhen me standardin e gjykatës së paanshme.

40.4 Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

Nga aktet e vëzhguara është konstatuar se gjyqtari Sokol Shehu komunikon me etikë me palët ndërgjyqëse. Ai ka aftësi komunikuese me palët ndërgjyqëse gjatë veprimtarisë përgatitore e gjyqësore, ku shfaq sjellje etike, duke ruajtur paanësinë në gjykim dhe respektuar barazinë e palëve.

DENONCIME

41. Për subjektin e rivlerësimit Sokol Shehu janë depozituar në total 6 denoncime nga publiku, të cilat, pasi u analizuan, kanë rezultuar se ankuesit ngrinin pretendime për vendimmarrjen e gjyqtarit dhe këto ankesa nuk përmbanin fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit. Pretendimet e ankuesve lidhur me vendimmarrjen e Gjykatës, në zbatim të Kodit të Procedurës Civile, vlerësohen nga një gjykatë më e lartë. Komisioni nuk ka kompetencë të vlerësojë vendimmarrjen e gjykatave.

42. Informacion i marrë nga mediat online

42.1 Nga një artikull i bërë publik në mediat *online* referohej se subjekti i rivlerësimit Sokol Shehu ka shqyrtuar një çështje në ngarkim të shtetasit B. B., si dhe ndaj tij ka dhënë vendimin nr. *** (2006), datë 29.6.2020.

42.2 Komisioni ka administruar dosjen penale dhe nga verifikimi i akteve ka rezultuar se: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër më 19.6.2020 ka paraqitur pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër kërkesën me objekt “Zëvendësimi i masës së sigurimit “Arrest në burg” për të pandehurin B. B. me masat e sigurimit “Detyrim për paraqitje”, si dhe “Ndalim i daljes jashtë shtetit”, duke parashtruar se: *“Në datën 31.1.2020, Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar Tiranë ka vendosur shpalljen e moskompetencës dhe kalimin e akteve Prokurorisë Shkodër për shtetasin B. B. etj., me argumentin se nuk jemi para grupit të strukturuar kriminal, si dhe veprës penale “Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm të personave që ushtrojnë funksione publike”, të parashikuar nga neni 245/2, për të cilin gjykata kishte vendosur masë sigurimi “Arrest në burg” ndaj shtetasit B. B.”.*

42.3 Çështja penale në ngarkim të të pandehurit B. B. është dërguar për gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër vetëm për akuzën e kryerjes së kundërvajtjes penale “Organizimi i lotarive të palejuara”, e kryer në bashkëpunim. Bazuar në kërkesën e prokurorit të çështjes për zëvendësimin e masës së sigurimit nga “Arrest në burg” në “Detyrim për paraqitje” dhe “Ndalimi i daljes jashtë shtetit”, gjyqtari Sokol Shehu ka vendosur pranimin e kërkesës si të bazuar në ligj e në prova.

42.4 Në zëvendësimin e masës së sigurisë mbahen parasysh parashikimet e nenit 244, pika 3 e Kodit të Procedurës Penale, sipas të cilit *“Gjykata nuk mund të caktojë një masë sigurimi më të rëndë se ajo e kërkuar nga prokurori”*, çka nënkupton se është prokurori i çështjes ai që vlerëson përshtatshmërinë e masës së sigurimit me nevojat e sigurimit.

42.5 Nga analizimi i akteve të dosjes nga Komisioni për zëvendësimin e masës së sigurimit personal nga “Arrest në burg” në “Detyrim për paraqitje”, rezultoi që gjyqtari Sokol Shehu ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Gjetje të tjera në lidhje me kriterin e aftësive profesionale

43. Në kuadër të informacioneve të raportuara nga institucionet ligjzbatuese, Komisioni ka kryer hetim të thelluar në lidhje me 4 çështje gjyqësore, të cilat u administruan dhe pas shqyrtimit të tyre:

✓ Nuk rezultuan problematika.

Rivlerësimi profesional sipas kriterëve të parashikuara në nenin 71 dhe vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

43.1 Gjatë procesit të vlerësimit përfundimtar të çështjes, bazuar në opinionin e Komisionit të Venecias²¹ dhe në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese²², të cilët kanë vendosur qartë kufirin ndarës për një vlerësim negativ të aftësive profesionale, i cili bëhet vetëm në rastet e gabimeve thelbësore dhe serioze dhe/ose kur ekziston një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara që tregojnë mungesë të aftësive profesionale të subjekteve të rivlerësimit, Komisioni nuk i çmoi problematikat e evidentuara dhe të trajtuara në këtë vendim si shkaqe që cenojnë aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit sipas parashikimeve të nenit E të Aneksit të Kushtetutës apo që ta bëjnë atë të papërshtatshëm në drejtim të aftësive profesionale, në kuptim të nenit 61/4 të ligjit nr. 84/2016.

43.2 Në përfundim, në zbatim të pikës 1 të neneve 42 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nenit 77 të ligjit nr. 96/2016, është kryer vlerësimi përfundimtar lidhur me secilin prej kritereve të vlerësimit të aftësive profesionale të magjistratit sipas kritereve të parashikuara në kreun II të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në zbatim të pikës 2 të nenit E të Aneksit të Kushtetutës, duke u vlerësuar se subjekti i rivlerësimit:

- a. ka treguar aftësi të mira profesionale sipas nenit 72 të ligjit nr. 96/2016;
- b. ka treguar aftësi të mira organizative sipas nenit 74 të ligjit nr. 96/2016;
- c. ka treguar etikë dhe angazhim ndaj vlerave profesionale sipas nenit 75 të ligjit nr. 96/2016;
- d. ka treguar aftësi personale dhe angazhim profesional sipas nenit 76 të ligjit nr. 96/2016.

Konkluzion lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

44. Nga hetimi i thellë administrativ, sipas parashikimeve në shkronjën “a” të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, me propozim të relatores së çështjes, për shkak se ka arritur një nivel kualifikues për vlerësimin e aftësive profesionale, si dhe është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme, subjekti i rivlerësimit është vlerësuar “i aftë” për kriterin profesional, në përputhje me shkronjën “c” të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.

KONKLUZION PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatores së çështjes, si dhe pasi dëgjoi subjektin në seancën dëgjimore publike, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Sokol Shehu ka plotësuar së bashku kushtet vijuese:

- a. ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar dhe në

²¹ Shihni opinionin nr. 824/2015 të Komisionit të Venecias.

²² Shihni vendimin nr. 2, datë 18.1.2017, të Gjykatës Kushtetuese.

bazë të shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 58, si dhe të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Sokol Shehu, gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër.
2. Ky vendim, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesit ndërkombëtar, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, më 9.11.2023.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Roland ILIA

Kryesues

Suela ZHEGU

Relatore

Genta TAFA (BUNGO)

Anëtare

Sekretare gjyqësore
Etmonda Hoxha